



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 29.11.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 21.11.2011,
3. Shqyrtimi i projektligjit për shërbime këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural,
4. Shqyrtimi në parim i projektligjit për bujqësinë organike,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të komisionit për komunitete rreth projektligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
6. Të ndryshme .

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18 dhe 21.11.2011 me ca shtesa nga **Sevdije Lama** e cila në mbledhjen e dt. 21.11.2011 anëtarëve të asociacionit të arkitektëve i ka parashtruar pyetjet si vijon : 1. A keni bashkëpunim me Këshillin për planifikim hapësinor, të cilët thanë se e kundërshtojnë këtë këshillë ngase është joprofesionist, përzgjedhja e tyre është bërë me delegim. 2. A keni bashkëpunim me shoqatën e ndërtimtarëve

dhe a mendoni më tutje me pas bashkëpunim me ta. 3. Sa anëtarë të licencuar i keni në asociacionin tuaj (70 anëtarë). 4. Meqenëse jeni anëtarësua në asociacionin ndërkombëtar të arkitektëve a duhet të presim vendosje të standardeve në urbanizëm dhe përmirësim të situatës.

3. Shqyrtimi i projektligjit për shërbime këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural

Salih Morina i sugjeroi kryetarit të komisionit të shqyrtohen dy shkresat e aritura për këtë projektligj, nga këshilltari i NDI dhe nga ministria e bujqësisë. Komisioni pas shqyrtimit të projektligjit nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Miratohet raporti me amendamente i raportuesit Salih Morina.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i projektligjit për Shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, me amendamentet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 2, në këtë nen hiqen thonjëzat në çdo përkufizim, në pikën 1.7, pas fjalisë së parë të shkruar me bold “është çdo person” bëhet “është personi”.

Amendamenti 2

Neni 3,

Riformulohet 1.2 : **Ngritja e nivelit të njohurive të këshilltarëve për bujqësi dhe zhvillim rural në mënyrë që shërbimet e tyre të ofrohen në kohën e duhur.**

Përmirësim teknik bëhet në pikën 1.8 : **Monitorimi i parametrave të ndryshëm në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.**

Pas pikës 1.8 shtohet 1.9 : **Nxitja e fermerëve për përshtatjen e prodhimtarisë së tyre me kushtet natyrore të rajoneve dhe kërkesat e tregjeve.**

Amendamenti 3

Neni 6, riformulohet titulli “Niveli qendror i shërbimit këshillues publik për bujqësi dhe zhvillim rural”.

Amendamenti 4

Neni 7, riformulohet titulli : “Niveli komunal i shërbimit këshillues publik për bujqësi dhe zhvillim rural”.

Amendamenti 5

Neni 10, paragrafi 1 riformulohet :

1. Personi juridik që ofron shërbime Këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të financuara nga fondet publike apo fondet ndërkombëtare, duhet të:

1.1. posedoj lejen e punës; dhe

1.2. të jetë i regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural në Ministri

Tek **paragrafi 2.1** në reshtin e parë fjala “tre” bëhet “dy” si dhe te **neni 18** te pika 2.3 në reshtin e parë “tre” bëhet “dy”.

Amendamenti 6

Neni 11, në paragrafin 2 reshti parë riformulohet : “**Shërbimit këshillues publik i ndalohet të :**”, në vazhdim në pikën 2.1 fjala e parë bëhet “**Reklamojë**”.

Pika 2.2 bëhet 3 dhe fjala e parë “Ndalimi” bëhet “**Të ndaloj**”, ndërkaq pika 2.3 bëhet 4.

Amendamenti 7

Neni 19, paragrafi 3 kalon në fund pas paragrafit 5, ndërkaq paragrafit 5 i shtohet pika 5.3 : **Nëse vërtetohet se personi juridik ka paraqitur të dhëna të pavërteta për tu regjistruar në regjistrin e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural për ti ofruar këto shërbime.**

Amendamenti 8

Neni 20, titulli riformulohet : **Regjistri i këshilltarëve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.**

Në paragrafin 3 në reshtin e dytë pas fjalës “regjistrin” shtohet “**të këshilltarëve për**”, në vazhdim hiqet “**të**”.

Në paragrafin 6 shtohet pika 6.3 : **Nëse vërtetohet se personi fizik ka paraqitur të dhëna të pavërteta për tu regjistruar në regjistrin e këshilltarëve për shërbime këshilluese në bujqësi dhe zhvillim rural për ti ofruar këto shërbime.**

Amendamenti 9

Neni 21, paragrafi 4 riformulohet : **Programi për certifikim të këshilltarëve hartohet nga Ministria.**

Amendamenti 10

Neni 26, paragrafi 1 riformulohet : **Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural formon komisionin për mbikëqyrjen dhe koordinimin e punëve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.**

4. Shqyrtimi në parim i projektligjit për bujqësinë organike dhe dy projektligjeve për parkun kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”

Lidhur me projektligjin e parë kryetari **Nait Hasani** ftoi zyrtarët e ministrisë të njoftojnë komisionin rreth qëndrimit që duhet të marr për leximin e parë. **Isuf Cikaqi** njoftoi komisionin se projektligji për bujqësinë organike është edhe në raportin e progresit ngase në ligjin që është në fuqi është dashur të bëhen përmirësimet të cilat janë kryer përmes ekspertëve të TAIEK dhe Italian. Me kërkesën e **Liburn Aliut** i njëjti njoftoi se ky ligj bënë fjalë për prodhimin organik pas zbatimit të metodave organike që janë trupa certifikuese në suaza të lejuara.

Lidhur me dy projektligjet tjera, komisioni konstatoi (**Liburn Aliu** dhe **Salih Morina**) se ka më tepër probleme me parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ku popullata kërkon edhe zgjidhjen e problemeve pronësore, çka nuk është fushë që rregullon ky ligj, mirëpo në vend se këto probleme ti rregulloi ministria, ajo ka dërguar në miratim në Kuvend këto dy projekte, ndërsa ligji ekzistues nga viti 1986 për Sharrin nuk është në zbatim. Megjithatë, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Miratohen në parim projektligji për Bujqësinë organike, parkun kombëtar “Sharri” dhe parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

5. Të ndryshme

Lidhur me rekomandimin trepikësh dhe kundërthënës nga komisioni për komunitete për projektligjin për Shitjen e banesave, komisioni u pajtua për këtë :

R E K O M A N D I M **për komisionin për legjislacion**

Të analizohen amendamentet e komisionit funksional dhe ekspertiza e dërguar nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve .

Në vazhdim **Nait Hasani** u fokusua në kërkesën e ministrit **Dardan Gashi** rreth rritjes buxhetore për këtë ministri. **Nijazi Idrizi** tha se nuk është qartë e shkruar shkresa nga ministria, ndërsa kryetari konstatoi se ky komision ka bërë më herët kërkesën e tillë për dy ministri, mirëpo pasi që është kjo më konkrete dhe i është dërguar komisionit për Buxhet, sugjeroi, ndërsa komisioni miratoi :

P Ë R F U N D I M I N

1. Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis mbështet kërkesën nr. 2573/11 dt. 24.11.2011 e Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor rreth rritjes buxhetore dhe kërkon mbështetje edhe nga Komisioni për buxhet dhe financa përmes amendamentimit të projektligjit për buxhetin e vitit 2012.

2. Pyetjet e parashtruara nga anëtarët e komisionit në mbledhjen e dt. 21.11.2011 ti dërgohen dy ministrive (MMPH dhe MBPZHR) për përgjigje konkrete.

Më 30 nëntor 2011 në tryezën që organizohet në Komoran shkon grupi punues për VSM dhe VNM : Sevdije Lama, Liburn Aliu, Nijazi Idrizi dhe Ylber Sherifi. Kryetari Nait Hasani do të bashkëngjitet nëse mundet.

Të premtën gjithashtu organizohen vizitat e GP sipas planit të monitorimit.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani